



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



|                        |   |            |                   |
|------------------------|---|------------|-------------------|
| DATË/A:                | 28.02.2023  | Dep. 06/01 | Mr. Dept. 3 23/23 |
| REFERENC-Ë:            | AKK-DPKI-06-4083/22   | Nr. Fq. 03 | Days 01.03.2023   |
| PËR/ZA/TO:             | z. Hysen YMERI,<br>Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve<br>Njerëzore në Komunën e Vitisë  |            |                   |
| CC:                    | z. Sokol HALITI,<br>Kryetar i Komunës së Vitisë   |            |                   |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  | z. Yll BULESHKAJ,<br>Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit  |            |                   |
| NGA/OD/FROM:           | Esad EJUPI,<br>Drejtor i Departamentit<br>për Parandalimin e Konfliktit të Interesit  |            |                   |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit lidhur me konkursin publik Nr. 02-111/01-649, të datës 28.06.2022, të shpallur nga Komuna e Vitisë |            |                   |

I nderuar z. Ymeri,

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit lidhur me konkursin publik Nr. 02-111/01-649, të datës 28.06.2022, të shpallur nga Komuna e Vitisë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. pika 1.1.1. dhe 1.1.4., të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nxjerrë këtë:

### OPINION

Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-4083/22, lidhur me konkursin publik Nr. 02-111/01-649, të datës 28.06.2022, të shpallur nga Komuna e Vitisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

### Arsyetim

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendime se: “[...] Në këtë konkurs ka pasur një mori shkeljes ligjore të cilat janë të lidhura ngushtë edhe me nepotizëm, konflikt interesi dhe korrupsion. Në bazë të rezultateve përfundimtare të gjithë kandidatët e pranuar sipas këtij konkursi kanë lidhje të ngushta familjare. Sipas konkursit në fjalë do të pranohen vetëm 3 kandidat, ndërsa kandidatja me më së shumti pikë është vajza e Drejtorit të shkollës në të cilën ajo tashmë ka filluar punën. Konkretisht bëhet fjalë për kandidaten e renditur me më së shumti pikë K.H. Përkundër që



*konkursi ende është në bazë të ankesave, në bazë të informatave që posedoj, ajo tanimë ka filluar punën në shkollën ku prindi i saj është drejtor shkolle. [...] Gjithashtu i gjithë konkursi është i bazuar në konflikt interesi, ndikim, korrupsion i cili është i lidhur ngushtë me përkatësinë partiake. [...] Tre kandidatët e përzgjedhur me më së shumti pikë: K.H. (vajza e drejtorit të shkollës ku është pranuar e njëjta, v.j.), D.A. (e afërt e udhëheqësit të Njësia së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë z. H. Y.), dhe D.H. Kandidatë tjerë në listë të pritjes të cilët po ashtu kanë filluar punën, janë: F.Q., A.S., E.O., SH.D.N., D.A., dhe M.SH.[...]*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës si më lartë, fillimisht me shkresën zyrtare DPKI-06-1/4622/22, ka kërkuar nga kryetari i Komunës së Vitisë informata, sqarime dhe dokumentacionin lidhur me konkursin publik Nr. 02-111/01-649, të datës 28.06.2022, të shpallur nga Komuna e Vitisë. Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit informatat, sqarimet dhe dokumentacionin përkatës lidhur me konkursin në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06-01/4622-1/22).

Në plotësim të informacionit dhe me qëllim të sqarimit të plotë të rastit në fjalë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar dhe ka pranuar dokumentacion relevant nga Agjencia e Regjistrimit Civil (shkresa zyrtare: DPKI-06-82/23, DPKI-06-82-1/23).

Pas trajtimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton si në vijim:

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

*“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.*

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

*“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

*“Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,*

si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

*“person i afërm me zyrtarin është - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.*



Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

*“Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen e cila lidhet me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, ndërsa sa i përket pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jenë plotësuar këto dy kushte kumulative, siç është vendimmarrja dhe interesi privat në çështjen konkrete.

Konkretisht, sipas verifikimeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Institucionet përkatëse, rezulton që, udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, z. H. Ymeri dhe kandidatja e përzgjedhur znj. D. A. nuk janë persona të afërm në kuptim të dispozitës përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6). Gjithashtu, sa i përket kandidatëve tjerë të referuar nga raportuesi i rastit, në rastet kur ekziston interesi privat i zyrtarit apo personave të afërm me të mungon vendimmarrja nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm) dhe anasjelltas, duke përjashtuar kështu konfliktin e interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me rastin e raportuar përkitazi me konkursin publik Nr. 02-111/01-649, të datës 28.06.2022, të shpallur nga Komuna e Vitisë.

Ky opinion i referohet situatës konkrete lidhur me pretendimet për konflikt të interesit dhe nuk trajton çështje tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!